VENDIM
Nr.1225, datë 11.12.2009

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2009, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË Z.FADIL MEHMETAJ, NË GJERMANI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.1.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, zëri "Shpenzime operative", t'i shtohet fondi 5 000 000 (pesë milionë)lekë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z.Fadil Mehmetaj, në Gjermani.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Pagesat të bëhen kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit shëndetësor të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha